Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas ksërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 30.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) e ndarë në VI LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-113-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 30.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) e ndarë në VI LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-113-2-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "2A Group shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 30.10.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) e ndarë në VI LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-113-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"7.1. Mosimplementimi i plotë dhe substancial i raportit të pranuar të ekspertit shqyrtues
Me datë 18.09.2026, 2A Group SH.P.K. paraqiti ankesë në OSHP, të regjistruar me nr. 2026/0718, lidhur me kushtet e dosjes së tenderit. Raporti i ekspertit shqyrtues Milaim Sylejmani i datës 23.09.2026, në faqet 24–25, i vlerësoi pretendimet si të bazuara dhe identifikoi tri problematika substanciale: kushtëzimin e liderit të grupit me përqindje në kapacitetet teknike; kërkimin e dokumenteve zyrtare të regjistrimit/doganimit të mjeteve në fazën e ofertimit; dhe kufijtë maksimalë teknikë që kufizojnë konkurrencën pa nevojë të provuar.
Eksperti rekomandoi aprovimin e ankesës, korrigjimin e dosjes dhe zgjatjen e afatit të ofertimit. Sipas vendimit të OSHP-së nr. 2026/0718, si AK ashtu edhe operatori ankues deklaruan pajtim me raportin më 28.09.2026. Paneli e përfundoi procedurën mbi bazën e këtij pajtimi dhe nuk bëri vlerësim meritor të veçantë për secilin pretendim.
Pikërisht për këtë arsye, pretendimi i tanishëm nuk e paraqet vendimin e OSHP-së si urdhër specifik që Paneli nuk e ka nxjerrë. Megjithatë, në faqen 3 të vendimit, Paneli ua kujton palëve nenin 19.4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, sipas të cilit, kur palët pajtohen me raportin, AK duhet ta implementojë raportin brenda afatit pesëditor dhe t'i njoftojë palët në procedurë.
Në dosjen e korrigjuar të datës 27.10.2026 janë bërë disa përmirësime reale: janë hequr shënimet e Aneksit 8 që kërkonin librezë me regjistrim valid gjatë vlerësimit, janë zgjeruar disa intervale të mjeteve dhe është zgjatur afati. Ne nuk i mohojmë këto ndryshime. Kundërshtimi është se ato nuk kanë eliminuar në përmbajtje kushtin individual të liderit në kapacitetet teknike, mospërputhjen FDT–Aneksi 8 për fazën e dokumentimit, si dhe një numër tavanish maksimalë të pajustifikuar.
Publikimi i një dosjeje të re dhe ndryshimi i shifrave nuk mjaftojnë vetvetiu për të vërtetuar zbatimin substancial të raportit. Duhet kontrolluar nëse pengesat që eksperti i identifikoi dhe AK i pranoi janë eliminuar realisht. Kërkesa jonë lidhet me këtë akt të ri korrigjues dhe me efektin e tij aktual mbi konkurrimin, jo me rihapjen formale të procedurës së përfunduar në OSHP.
7.2 Ulja nga 60 në 50 për qind ruan pengesën për grupin
FDT, te kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional, ruan pjesëmarrjen minimale 50% të liderit në kërkesën 1 për kontratat e ngjashme, kërkesën 3 për punëtorët dhe kërkesën 6 për pajisjet. Ndryshimi i shifrës 60% në 50% nuk e heq detyrimin që lideri ta zotërojë individualisht gjysmën e secilit kapacitet teknik.
Kjo pengesë kufizon mënyrën e bashkimit të kapaciteteve dhe mund të përjashtojë një grup që, në tërësi, i plotëson kapacitetet e nevojshme. Raporti i pranuar e ka kundërshtuar pikërisht kushtëzimin teknik të liderit, duke dalluar kapacitetet teknike të kombinuara nga kërkesa e lejuar për liderin në fushën financiare. Ky pretendim nuk kërkon heqjen automatike të përqindjes 60% për qarkullimin financiar.
E kemi parasysh formulimin e nenit 26.10 të Rregullores për kushtet minimale të liderit kur janë të nevojshme. Megjithatë, AK duhet ta lidhë një kufizim të tillë me një nevojë konkrete dhe proporcionale, ta pajtojë me nenin 26.5, me rregullat për kapacitetin e grupit dhe me raportin që vetë e ka pranuar. Në dosjen e korrigjuar, ndryshimi i përqindjes nuk e jep këtë arsyetim.
Korrigjimi i kërkuar: të hiqet kushti 50% për liderin në kërkesen teknike 6 dhe të përcaktohet qartë se grupi i plotëson bashkërisht këto kapacitete, duke dëshmuar disponueshmërinë e kapacietit teknik dhe profesional për ekzekutimin e kontratës.
7.3 Dëshmia 6 dhe Aneksi 8 lënë rregulla të ndryshme për dokumentet e mjeteve
Raporti i ekspertit ka vlerësuar se në fazën e ofertimit është e mjaftueshme dëshmia e pronësisë ose e disponueshmërisë së pajisjeve, përfshirë qiranë, ndërsa dokumentet zyrtare të regjistrimit mund të kërkohen para nënshkrimit të kontratës. Në dosjen aktuale, Aneksi 8 e zhvendos kërkesën për dokumentacion të rregullt dhe valid në fazën e fillimit të realizimit të shërbimeve, çka përbën përmirësim krahasuar me versionin paraprak.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Megjithatë, FDT, te "Dëshmia 6", vazhdon të kërkojë me ofertë kopje të librezave të qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Për pajisjet që nuk regjistrohen lejon faturë blerjeje, DUD ose dokumente të tjera pronësie; kur pajisja nuk është në pronësi, lejon marrëveshje përdorimi, kontratë qiraje ose dokument ekuivalent. Për rrjedhojë, nuk pretendojmë se DUD është dokumenti i vetëm i lejuar ose se për çdo kategori mjeti kërkohet shprehimisht regjistrim valid në ditën e ofertimit. Problemi mbetet kërkimi i librezës si dokument i ofertës për kategorinë e mjeteve të regjistrueshme dhe mungesa e një rregulli të harmonizuar për provat alternative.

Aneksi 8 parasheh edhe dokumente që vërtetojnë destinimin e mjeteve (librezë, DUD ose pëlqim i autoritetit kompetent), dy fotografi të mjetit me ofertë dhe krahasimin e tij në fillim të realizimit. Në fund, Aneksi 8 përcakton përparësi ndaj Aneksit 1 në rast mospërputhjeje teknike. Por kjo nuk e përcakton shprehimisht përparësinë e Aneksit 8 ndaj Dëshmisë 6 të FDT-së. Për këtë arsye, operatori nuk mund të dijë me siguri nëse mungesa e librezës në ofertë, kur pronësia ose e drejta e përdorimit provohet ndryshe, mund të sjellë eliminimin.

Kjo paqartësi ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen e ofertës dhe në trajtimin e barabartë të tenderuesve. Nuk mjafton që dy pjesë të dosjes të përmbajnë afate të ndryshme për dokumentacionin pa përcaktuar qartë se cilat prova janë të domosdoshme në secilën fazë.

Korrigjimi i kërkuar: Të harmonizohen Dëshmia 6 dhe Aneksi 8 në mënyrë që me ofertë të pranohen prova të mjaftueshme për identifikimin, pronësinë ose disponueshmërinë e mjetit, përfshirë marrëveshje qiraje/përdorimi apo dokument ekuivalent; libreza dhe DUD-i të pranohen si prova kur ekzistojnë, pa u bërë kushte ekskluzive në ofertim. Dokumentet zyrtare të regjistrimit të kërkohen nga operatori i përzgjedhur para nënshkrimit të kontratës, sipas raportit të ekspertit, ndërsa dokumentacioni i vlefshëm për përdorim të jetë i siguruar para fillimit dhe gjatë realizimit të shërbimeve.

7.4 Tavanet numerike nuk janë korrigjuar sipas nevojës funksionale

Raporti i ekspertit (fq. 25) kundërshtoi vendosjen e tavaneve maksimale të kapaciteteve që mund të përjashtojnë mjete funksionalisht të përshtatshme. Në dosjen aktuale AK ka zgjeruar disa intervale, por ka ruajtur në shumë pozicione kufijtë maksimalë në peshë, bartje ose litrazh. Në disa raste maksimumi ka mbetur i pandryshuar, ndërsa në LOT IV, pozicioni 6, është ulur nga 17,000 në 16,000 litra.

Tabela në vijim krahason Aneksin 8 të dosjes së datës 14.09.2026 (versioni para raportit të ekspertit) me Aneksin 8 të datës 27.10.2026. Këto janë shembuj konkretë, jo listë shteruese e të gjitha kufizimeve të kësaj natyre.

Pranojmë se në disa pozicione ka korrigjime reale: për shembull, maksimumi 2 m³ i kompresorit në LOT III / 3, i pasqyruar në korrigjimet para raportit, nuk figuron më; në LOT II / 15 nuk ruhet minimumi 180 kg i atij korrigjimi. Këto përmirësime nuk e arsyetojnë ruajtjen e tavaneve të tjera.

Aneksi 1 jep shpjegime të përgjithshme për kategoritë e mjeteve dhe terrenin. Këto nuk tregojnë, për shembull, pse një ekskavator funksionalisht i përshtatshëm mbi 10 ton në LOT I / 12 ose një mjet mbi 16,000 litra në LOT IV / 6 duhet të përjashtohet. AK duhet të lidhë secilin kufi me rrugë, përmasa, siguri, ngarkesë ose pengesë tjetër konkrete, duke treguar pse alternativa më pak kufizuese nuk e përmbush të njëjtën nevojë.

Nuk kërkojmë heqjen mekanike të çdo maksimumi, përfshirë kufijtë e ligjshëm të sigurisë ose parametrat e domosdoshëm të punës. Kërkojmë heqjen e tavaneve të pajustifikuara që e përjashtojnë pajisjen për shkak të një kapaciteti më të lartë, megjithëse ajo e kryen shërbimin në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme.

Korrigjimi i kërkuar: të zëvendësohen këto tavane me kërkesa minimale ose funksionale. Nëse mbahet ndonjë maksimum, AK të publikojë arsyetim teknik individual e të matshëm dhe të lejojë zgjidhje ekuivalente që i plotësojnë kufizimet objektive, në përputhje me raportin e pranuar.

.

7.5 Formulimet e paqarta pengojnë një ofertë të krahasueshme

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Në Aneksin 8 mbeten edhe formulime që kërkojnë korrigjim të qartë dhe nuk mund të interpretohen në dëm të tenderuesit:
1. LOT II / 9 përmban dy minimume, "min 6,000 min 10,000 litra". AK duhet të shpallë kapacitetin e kërkuar në mënyrë të vetme dhe të qartë. Fjala e dytë "min" nuk mund të lexohet vetvetiu si "max".
2. LOT III / 1 dhe LOT IV / 1 e shprehin "peshën" përkatësisht në 300 L dhe 250 L. Litra është njësi vëllimi. Duhet të sqarohet karakteristika e kërkuar dhe njësia matëse, duke shmangur dykuptimësinë ndërmjet peshës dhe kapacitetit.
3. LOT III / 6, LOT IV / 3 dhe LOT VI / 3 përmbajnë shprehjen "6 ≥ m gjatësi". Duhet të përcaktohet qartë objekti i matjes dhe nëse kërkohet gjatësi minimale apo maksimale.
4. LOT VI / 6 dhe / 7 përmbajnë minimum 1,600 litra dhe maksimume përkatësisht 20,000 dhe 21,000 litra. Kërkojmë konfirmim ose korrigjim formal të minimumit të publikuar; ai nuk mund të ndryshohet gjatë vlerësimit me supozimin se është 16,000 litra. Korrigjimi i kërkuar: Të përcaktohen në mënyrë të saktë parametri, njësia matëse, minimumi, maksimumi i justifikuar dhe objekti i matjes për secilin pozicion të identifikuar; korrigjimet të pasqyrohen njësoj në të gjitha pjesët përkatëse të dosjes dhe të publikohen para ofertimit. 7.6 Zbatimi i dispozitave mbi faktet e dokumentuara. Për pretendimin e liderit, objekti i kërkesës nuk është ulja e një shifre, por largimi i kushtëzimit individual në tri kapacitetet teknike. Neni 71.4 i LPP-së i orienton kërkesat e neneve 68–69 drejt grupit si tërësi. Neni 26.10 i RRPP-së duhet të lexohet në pajtim me këtë rregull dhe me kushtin e vet të nevojshmërisë. Edhe sipas leximit më të gjerë të këtij neni, AK duhet të shpjegojë pse realizimi i shërbimit kërkon që lideri të sigurojë pikërisht gjysmën e kontratave, gjysmën e punëtorëve dhe gjysmën e pajisjeve. Aftësia e grupit për realizimin e kontratës nuk provohet më mirë thjesht nga fakti se cili anëtar i zotëron burimet. Udhëzuesi nr. 002/2024, fq. 33, e lidh përqindjen minimale të liderit me kërkesat ekonomike dhe financiare. Raporti i ekspertit, fq. 25, e ka zbatuar këtë dallim në këtë tender dhe AK e ka pranuar. Në këto rrethana, ruajtja e kushtit teknik me një shifër më të ulët kërkon një bazë e arsyetim që e trajton drejtpërdrejt këtë kundërshtim; ndryshimi 60% në 50% nuk e siguron këtë. Për dokumentet e mjeteve, pika e kontrollit është faza kur kërkohet dokumenti dhe funksioni i tij. Pronësia ose e drejta e përdorimit provon disponueshmërinë; regjistrimi valid provon lejueshmërinë operative në fazën përkatëse. Kur FDT ruan librezën si dokument të ofertës, ndërsa Aneksi 8 flet për dokumentet valide në fillim të shërbimit, operatori nuk mund të përcaktojë me siguri pasojën e mungesës së librezës në ofertë. Kjo paqartësi ka efekt të drejtpërdrejtë në pranueshmëri dhe nuk zgjidhet nga një shënim që vendos vetëm përparësinë ndaj Aneksit 1. Për tavanet teknike, një pajisje që tejkalon maksimumin përjashtohet nga intervali i shkruar edhe kur e plotëson minimumin dhe e kryen shërbimin. Prandaj AK duhet të identifikojë pengesën objektive që e bën të papërshtatshme pajisjen mbi kufi. Arsyetimi i përgjithshëm për rrugë të ngushta dhe kategori mjetesh nuk demonstron vetvetiu pse çdo prag në ton ose litra është i nevojshëm. Duhet lidhje e verifikueshme me përmasat e kalimit, ngarkesën e lejueshme, sigurinë ose kushtin tjetër teknik të pozicionit konkret. Shembulli LOT IV / 6 është veçanërisht domethënës: tavani 16,000 litra në dosjen aktuale është më i ulët se tavani 17,000 litra në versionin e 28.08.2026. Një mjet me 16,500 litra del jashtë intervalit aktual. Ky është ilustrim i efektit të kriterit dhe jo pretendim për flotën që zotëron OE. AK duhet të shpjegojë përse ky mjet do të ishte funksionalisht i papranueshëm; vetëm shënimi i intervalit nuk është shpjegim teknik.
Ligjshmëria e këtyre kushteve vlerësohet sipas efektit objektiv dhe proporcionalitetit. Për korrigjimin nuk është e domosdoshme të provohet paraprakisht se kujt i janë përshtatur kriteret. Kërkesa mbështetet në tekstin e dokumenteve dhe pasojat e tyre për konkurrimin, në përputhje edhe me vërejtjen e ekspertit se nuk ka prova për inspektim të flotave të operatorëve nga AK.
7.7 Teksti i korrigjimit që kërkohet
Për kërkesat teknike 1, 3 dhe 6 të FDT-së: "Në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, kapacitetet e kërkuara teknike dhe profesionale plotësohen nga grupi si tërësi. Grupit i kërkohet të dëshmojë se burimet përkatëse do t'i ketë në dispozicion për realizimin e kontratës." Të hiqet nga këto kërkesa kushti që lideri të plotësojë 50%. Për Dëshminë 6: "Me ofertë dorëzohet lista e pajisjeve të propozuara dhe dokumentacion i mjaftueshëm për identifikimin dhe pronësinë ose disponueshmërinë e tyre për

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

ekzekutimin e kontratës. Pranohen dëshmi pronësie dhe marrëveshje qiraje, shfrytëzimi ose ekuivalente. Libreza e regjistrimit dhe DUD-i mund të përdoren si prova kur janë të disponueshme; nuk përbëjnë kusht ekskluziv në fazën e ofertimit kur disponueshmëria provohet ndryshe në mënyrë të mjaftueshme. Dokumentet zyrtare të regjistrimit kërkohen nga operatori i përzgjedhur para nënshkrimit të kontratës, sipas raportit të pranuar. Mjetet duhet të kenë dokumentacionin valid për përdorim përpara fillimit dhe gjatë kryerjes së shërbimit." Për pajisjet: të përcaktohet minimumi i nevojshëm dhe funksioni që duhet të realizojë secili mjet. Të hiqet refuzimi vetëm për shkak të tejkalimit të një tavani të pajustifikuar. Për maksimumin që lidhet me një pengesë objektive, AK të publikojë veçmas për pozicionin parametrin kufizues, faktin teknik që e mbështet dhe mënyrën e pranimit të zgjidhjes funksionalisht ekuivalente. Për pozicionet me dy minimume, njësi të gabuara ose shenjë të paqartë: korrigjimi duhet të bëhet para ofertimit, me tekst të njëjtë në të gjitha pjesët e dosjes. Sqarimi gjatë vlerësimit nuk mund të përdoret për ta zëvendësuar shifrën ose njësinë e publikuar me një kërkesë që operatorët nuk e kanë pasur të qartë gjatë përgatitjes".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi dhe posaçërisht me vendimin përkatës të OSHP.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net